

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
“BN Production” sh.p.k

Tiranë, më datë 30/11/2022

NENI 1

Shoqëria Tregtare “BN Production” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “BN Production” sh.p.k

NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:

Regjimin e perpunimit aktiv të mallrave, punime me material porosities ose fason. Shoqëria do të perpunojë, prodhojë dhe tregtojë import-eksport material industrial dhe të tjera të ngjashme. Pjesë e aktivitetit të shoqërisë do të jete edhe cdo aktivitet tjetër i lejuar nga ligji. Prodhim i kepuceve të çdo lloji, eksport import dhe tregtimi i tyre. Prodhim veshmbathje tekstile, të pambukta dhe të leshta të të gjitha llojeve. Importimi dhe eksportimi i tyre. Prodhim i rrobave të gatshme dhe artizanale. Tregtim të artikujve të ndryshme industriale, ushqimore, lendeve të para, makineri e pjesë kembime për makineri të ndryshme, pajisje elektrike, elektronike, elektroshtepiake, kompjutera, tregtim automjetesh, etj. Aktivitet në fushën e regjimit të perpunimit aktiv Fason. Për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqëria mund të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqëri të tjera, konsorciume ose kompani të cilat kanë objekte të ngjashme apo analoge me të vetin dhe të kryeje të gjitha veprimet komerciale, industriale, financiare. Në vecanti, shoqëria, mund të marrë në pronësi, ose qera, kompani ose dege kompanish që operojnë në fushën e një ose me shumë prej veprimtarive të mesiperme. Gjithmone, për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqëria mundet gjithashtu të japë garanci, garanci mbi kreditë dhe depozitat, le lere peng të mira dhe vlera të tundshme, të vendose garanci hipotekore mbi të mirat e patundshme dhe të tundshme të regjistruara etj.

NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Autostrada Tirane-Durres, Km 11, Kapanoni Prane Kato Vores, Pasuria Nr. 131/13, Zona Kadastrale Nr. 2183, Vol. 7, Faqe 219, Vore, Tirane.



NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 Lek. Kapitali ndahet në një (1) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Bledi Balla, shtetas Shqiptar, Lindur në Tiranë, më 21.09.1987, me nr. personal I70921049R i cili zotëron 100% të kuotave, e barabartë me një pjesë kapitali, me vlerë të përgjithshme prej 100.000 lek. .

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7 - ORGANET DREJTUESE

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Bledi Balla, shtetas Shqiptar, Lindur në Tiranë, më 21.09.1987, me nr. personal I70921049R, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9



Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

Bledi Balla

Bledi

Balla



(emer, mbiemer, firme)